



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 938/1 Prot.

Tiranë, më 28.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 134, Datë 28.05.2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 120, datë 13.05.2026, të paraqitur nga z. E. Rr., kundër Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “çdo shkakut tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *Unë, E. Rr., aktualisht jam 46 vjeç, babai i një vajze të mitur dhe kryefamiljar. Sot ndodhem përballë një situatë që e konsideroj diskriminuese dhe të padrejtë, pasi jam larguar nga puna për shkak të një dënimi penal të vuajtur dhe të përfunduar prej meje në periudhën 2003–2006, në një kohë kur kam qenë vetëm 23 deri në 26 vjeç. Pas përfundimit të dënimit jam rikthyer në Shqipëri, ku kam vazhduar studimet universitare dhe më pas kam ndërtuar jetën time profesionale dhe familjare. Kam punuar për vite me radhë, pothuajse pa ndërprerje, si në administratën shtetërore ashtu edhe në sektorin privat. Gjatë gjithë kësaj periudhe nuk kam pasur asnjë problem me drejtësinë, as në Shqipëri dhe as jashtë saj. Kam qenë i përkushtuar ndaj familjes, punës dhe integritetit tim në shoqëri.*

*Më datë 07.02.2025 më është dhënë nga kolegët formulari i vetëdeklarimit, të cilin e kam plotësuar me korrektësi dhe transparencë të plotë, duke deklaruar dënimin tim të mëparshëm. Megjithatë, më datë 03.12.2025 më është komunikuar zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënies së punës, me shënimin “largim sipas vendimit”. Ky vendim ka sjellë pasoja të rënda ekonomike dhe familjare për mua, duke qenë se kam në ngarkim një vajzë të mitur, për të cilën siguroj jetesën dhe kujdesin e nevojshëm.*

*E konsideroj të padrejtë që ndaj meje të përdoret një dënim shumë i vjetër, i cili është ekzekutuar dhe mbyllur prej gati dy dekadash. Pas përfundimit të tij, kam jetuar në mënyrë të rregullt dhe*

*kam kontribuar në shoqëri përmes punës dhe jetës familjare. Besoj se nuk është respektuar parimi i rehabilitimit, pasi megjithëse kam kryer dhe përfunduar dënimin, vazhdoj të penalizohem për të njëjtin fakt edhe pas kaq shumë vitesh.*

*Gjithashtu, vepra penale për të cilën jam dënuar nuk lidhet drejtpërdrejt me funksionin që ushtroja pranë sektorit të mbledhjes së të dhënave, ndaj masa e largimit nga puna më duket joproporcionale. Vendimi më ka cenuar të drejtën për punë, dinjitetin dhe mundësinë për të siguruar jetesën e familjes sime. Për më tepër, largimi nga puna dhe pasojat që rrjedhin prej tij ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien ekonomike dhe sociale të vajzës sime të mitur dhe krijojnë për mua pasoja afatgjata në raport me mundësinë për të ushtruar profesionin në administratën shtetërore.*

*Po ashtu, vlerësoj se nuk është bërë një vlerësim individual i rastit tim, i sjelljes sime në punë, i kohës së kaluar që nga dënimi, si dhe i integritit tim shoqëror dhe profesional. Gjatë gjithë viteve pas përfundimit të dënimit kam treguar sjellje korrekte, kam punuar dhe kam jetuar si një qytetar i rregullt, pa asnjë problem me ligjin.*

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

1. Kërkohet shqyrtimi i rastit dhe konstatimi i mundshëm i trajtimit diskriminues në lidhje me vendimin për largimin nga puna, si dhe marrja e masave përkatëse në përputhje me kompetencat ligjore.
2. Kërkohet gjithashtu marrja e masave administrative ndaj punëdhënësit, nëse konstatohet shkelje e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.
3. Po ashtu, kërkohet garantimi i mosdiskriminimit në të ardhmen dhe vlerësimi i pasojave ekonomike dhe morale të shkaktuara nga largimi nga puna, duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale ekonomike dhe familjare të ankuesit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me

*Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

*Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:*

- Me vendimin nr. 86, datë 06.02.2025, Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. emëroi z. E. Rr., në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Mbledhjes së të Dhënave në Drejtorinë e Taksave, bazuar në Kodin e Punës dhe aktet e brendshme të shoqërisë, me fillim të marrëdhënies së punës më 07.02.2025.
- Në datën 07.02.2025, z. Rr., plotësoi formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, duke deklaruar dënimin e mëparshëm në Itali për trafik narkotikësh, si dhe të dhëna mbi hetimin, arrestimin dhe masat e sigurisë të lidhura me këtë çështje, formular i administruar nga Departamenti i Administratës Publike.
- Po në të njëjtën datë, u lidh kontrata individuale e punës ndërmjet palëve, duke përcaktuar kushtet e punës, pagën, orarin dhe të drejtat e detyrimit sipas Kodit të Punës dhe kontratës kolektive të UKT sh.a.
- Pas verifikimeve të kryera nga Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me vendimin e datës 14.11.2025 të Prokurorisë së Përgjithshme u konstatua se z. Rr., rezultoi i dënuar në Itali për trafik narkotikësh, si dhe janë evidentuar të dhëna mbi hetimin, arrestimin dhe masat e sigurisë ndaj tij në periudhën 2003–2006, ndërsa u konfirmua mungesa e procedimeve të tjera penale, urdhrave ndërkombëtarë apo masave të dëbimit. Në pikën 2 të këtij vendimi ndër të tjera, është vendosur: ....*Departamenti i Administratës Publike, i cili si organ kompetent në zbatim të nenit 12 dhe 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, duhet të shqyrtojë nëse janë evidentuar të dhëna që përfshihen në sferën e kufizimeve të nenit 2 të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, dhe në vijim, të vlerësoj nëse ato janë brenda periudhës së ndalimit të përcaktuara në nenin 4 të po këtij ligji.*

- Në vijim, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën e datës 21.11.2025, konstatoi se z. Rr., përfshihet në sferën e ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 1/a të ndalimeve të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, dhe se kishte pasqyruar të dhëna të paplota dhe të pasakta në formularin e vetëdeklarimit, duke kërkuar marrjen e veprimeve të nevojshme nga UKT sh.a., për zbatimin e parashikimeve të përcaktuara në nenin 13 të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, dhe gërmën “ç”, të pikës 3, të kreut III, të Vendimit të Kuvendit nr.17/2016.
- UKT sh.a. kundërshtoi këtë qëndrim me shkresën e datës 11.12.2025, duke argumentuar se ligji nr. 138/2015 nuk zbatohet për pozicionin e punës së z. Rr., se dënimi ishte i përfunduar dhe pa efekt aktual, dhe se nuk kishte kompetencë sanksionuese nga DAP.
- Megjithatë, me vendimin nr. 887, datë 03.12.2025, Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a. vendosi zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës së z. Rr., duke u bazuar në shkresën e DAP dhe vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, për shkak të deklarimeve të pasakta në formularin e vetëdeklarimit, me efekt ndërprerjen e marrëdhënieve financiare nga data 03.12.2025.

Me ankesën e datës 12.05.2026, paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. E. Rr., kundërshtoi vendimin e largimit nga puna të datës 03.12.2025 të Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., duke pretenduar se ishte subjekt i një trajtimi diskriminues dhe disproporcional, për shkak të një dënimi të vjetër penal të vuajtur jashtë vendit. Ankuesi pretendoi se nuk ishte respektuar parimi i rehabilitimit, se vepra penale nuk lidhej me funksionin e ushtruar prej tij dhe se largimi nga puna kishte cenuar të drejtën për punë, dinjitetin dhe gjendjen ekonomiko-sociale të familjes së tij. Për këtë arsye, ai kërkoi rishikimin e vendimit të largimit, rikthimin në punë dhe marrjen e masave për garantimin e mosdiskriminimit.

Sa më sipër, vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme, datë 14.11.2025, dhe shkresa nr. 1600/8 prot., datë 21.11.2025, e Departamentit të Administratës Publike (DAP), kanë konstatuar se z. E. Rr., rezulton i dënuar nga Gjykata e Padovës, Itali, për veprën penale të “trafikut të narkotikëve”, të parashikuar nga neni 73 i Dekretit Presidencial italian nr. 309/1990, vepër e cila korrespondon me nenin 283, paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye, organet kompetente kanë vlerësuar se ai përfshihet në kategorinë e subjekteve të parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja “a”, e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

Në interpretimin e bërë nga DAP sipas kostatimeve të Prokurorisë së Përgjithshme, ky klasifikim vjen si pasojë i zbatimit të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, i cili parashikon ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike për personat e dënuar për veprat penale të përfshira në këtë dispozitë. Sipas këtij interpretimi, pozicioni i mbajtur nga z. Rr., pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., konkretisht ai i Përgjegjësit të Sektorit të Mbledhjes së të Dhënave, është konsideruar si funksion që hyn në kategorinë e përcaktuar nga neni 3/ç i ligjit, përkatësisht drejtues të çdo niveli në administratën publike qendrore ose vendore që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Në këto kushte, masa e largimit nga puna e z. Rr., është trajtuar nga organet shtetërore jo si një masë disiplinore apo si një vendimmarrje diskrecionale e punëdhënësit, por si pasojë e drejtpërdrejtë e zbatimit të një ndalimi ligjor të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar. Në këtë kuadër, UKT sh.a. ka vepruar në cilësinë e subjektit zbatues të kërkesave të përcaktuara nga DAP dhe Prokuroria e Përgjithshme, duke mbështetur vendimin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në aktet dhe interpretimet e organeve kompetente shtetërore.

Për rrjedhojë, çështja e ngritur nga ankuesi lidhet në thelb me ligjshmërinë dhe mënyrën e interpretimit të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, si dhe me efektet juridike që burojnë nga ky ligj mbi ushtrimin e funksioneve publike. Vlerësimi nëse pozicioni i mbajtur nga z. Rr., përfshihet ose jo në kategoritë e ndaluara nga ligji, si dhe nëse rehabilitimi penal apo kalimi i kohës ndikojnë në shuarjen e këtyre kufizimeve, përbën çështje interpretimi dhe kontrolli të ligjshmërisë administrative, që i takon organeve dhe juridiksioneve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Në këto kushte, në zbatim të kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrton çështje që lidhen me ekzistencën e diskriminimit dhe respektimin e parimit të barazisë në trajtim. Në rastin konkret, referuar natyrës së pretendimeve dhe akteve administrative të administruara, çështja lidhet me zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, dhe pasojat juridike që burojnë prej tij, duke dalë kështu jashtë fushës së kompetencës materiale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.” Komisioneri arrin në përfundimin se, nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar shqyrtimit të mëtejshëm.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “b” dhe nenin 33, pika 4, germa “b”, të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës Nr. 120 Regjistri me subjekt ankues z. E. Rr., pa një vendim përfundimtar për çështjen, pasi nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, sipas Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**